

# Lejet e ndërtimit


## Tremujori III, 2019

**Tiranë, më 27 Nëntor 2019:** Në tremujorin e tretë 2019 janë miratuar gjithsej 293 leje ndërtimi për ndërtesa të reja, nga 343 leje të miratuara në tremujorin e tretë 2018, duke shënuar një rënie prej 14,6 %.

Sipërfaqja e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja, në tremujorin e tretë 2019, është 685.455 m<sup>2</sup>, nga 330.725 m<sup>2</sup> miratuar në tremujorin e tretë 2018, duke shënuar një rritje me 2,1 herë.

Vlera e përafërt e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa dhe punime inxhinierike, në tremujorin e tretë 2019, është 25,6 miliardë lekë, nga 15,2 miliardë lekë miratuar në tremujorin e tretë 2018, duke shënuar një rritje prej 68,0 %.

Fig. 1 Struktura e vlerës së përafërt të lejeve të ndërtimit



**Tab.1 Lejet e ndërtimit miratuar për ndërtesa dhe punime inxhinierike, T3 - 2019**

Llojet e Ndërtimeve	Numër	Sipërfaqe m <sup>2</sup>	Ndërtime të reja 000 / lekë	Rikonstruksione 000 / lekë
<b>Gjithsej</b>			<b>22.330.187</b>	<b>3.270.144</b>
<b>I. Ndërtesa</b>	<b>293</b>	<b>685.455</b>	<b>21.811.968</b>	<b>1.317.409</b>
1.Ndërtime për banim (rezidente)	202	495.420	17.592.139	487.227
a. Me një kat	53	6.390	208.454	99.598
b. Me dy kate	96	20.736	602.131	249.984
c. Me tre ose më shumë kate	49	400.941	14.069.578	21.429
d. Rezidenca për komunitetet	4	67.353	2.711.976	116.216
2.Ndërtesa të tjera (jo rezidente)	91	190.035	4.219.829	830.182
a. Hotele dhe të ngjashme	16	87.000	1.855.034	7.610
b. Ndërtesa për zyra	1	178	9.058	0
c. Ndërtesa tregtare	20	18.941	527.563	40.063
d. Ndërtesa industriale	33	57.920	1.244.259	257.764
e. Ndërtesa të tjera	21	25.996	583.915	524.745
<b>II. Punime inxhinierike</b>			<b>518.219</b>	<b>1.952.735</b>
1. Infrastruktura e transportit; Rrugë e autostrada			161.311	953.767
2. Linjat e ujësjellësve,elektrike dhe telekomunikacionit			341.031	998.968
3. Ndërtime komplekse në kantieret industriale			5.967	0
4. Punime të tjera inxhinierike			9.910	0

\* Të dhënat për numrin dhe sipërfaqjen e ndërtesave i përkasin vetëm ndërtimeve të reja.

**Tab.2 Numri i lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja**

Qarqet	III - 18	IV - 18	I - 19	II - 19	III - 19
<b>Shqipëria</b>	<b>343</b>	<b>360</b>	<b>245</b>	<b>310</b>	<b>293</b>
Berat	20	12	7	6	4
Dibër	16	5	1	2	12
Durrës	51	44	26	55	48
Elbasan	30	29	24	29	21
Fier	34	30	20	20	35
Gjirokastër	13	16	8	7	4
Korçë	24	35	17	22	18
Kukës	2	3	1	6	5
Lezhë	10	19	24	10	16
Shkodër	27	29	8	24	4
Tiranë	104	120	94	111	108
Vlorë	12	18	15	18	18

\* Të dhënat për numrin e ndërtesave i përkasin vetëm ndërtimeve të reja.

\*\* Në informacionin e qarikut Tiranë, mungojnë të dhënat mbi bashkinë Kamëz për tremujorin e dytë dhe tremujorin e tretë 2019.

**Tab.3 Sipërfaqja e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja**

Qarqet	III - 18	IV - 18	I - 19	II - 19	III - 19
<b>Shqipëria</b>	<b>330.725</b>	<b>618.219</b>	<b>581.236</b>	<b>409.548</b>	<b>685.455</b>
Berat	5.702	13.571	3.089	1.856	1.448
Dibër	3.671	1.189	681	503	5.993
Durrës	81.802	47.154	21.580	60.708	34.685
Elbasan	8.061	16.978	18.836	11.847	8.410
Fier	26.977	6.572	14.062	6.928	18.597
Gjirokastër	2.530	6.520	1.448	8.168	1.492
Korçë	5.957	20.380	4.182	11.322	7.238
Kukës	2.423	740	359	4.423	4.836
Lezhë	3.126	14.585	26.567	6.062	36.408
Shkodër	9.123	26.211	2.543	11.514	713
Tiranë	165.725	456.480	479.954	273.133	556.848
Vlorë	15.628	7.839	7.935	13.084	8.787

\* Të dhënat për sipërfaqen e ndërtesave i përkasin vetëm ndërtimeve të reja.

\*\* Në informacionin e qarkut Tiranë, mungojnë të dhënat mbi bashkinë Kamëz për tremujorin e dytë dhe tremujorin e tretë 2019.

**Tab.4 Vlera e përafërt e lejeve të ndërtimit miratuar për ndërtesa dhe punime inxhinierike**

Qarqet	III - 18	IV - 18	I - 19	II - 19	III - 19
<b>Shqipëria</b>	<b>15.240.853</b>	<b>22.140.540</b>	<b>25.216.754</b>	<b>16.792.172</b>	<b>25.600.331</b>
Berat	302.057	584.440	215.209	301.059	83.304
Dibër	220.312	87.914	22.863	84.834	366.053
Durrës	2.700.649	2.093.900	692.523	2.309.790	1.190.215
Elbasan	1.065.704	599.773	1.034.810	1.050.083	802.368
Fier	3.159.743	1.354.519	931.316	807.316	1.071.093
Gjirokastër	105.838	333.949	222.707	274.051	133.463
Korçë	261.501	853.060	455.475	440.280	252.804
Kukës	122.175	34.626	11.800	195.183	222.348
Lezhë	212.870	495.780	2.862.205	277.277	664.846
Shkodër	374.712	1.039.427	735.623	421.698	1.065.159
Tiranë	6.361.955	14.329.332	17.678.507	9.880.140	18.607.334
Vlorë	353.337	333.820	353.716	750.461	1.141.344

\* Vlera e përafërt përfshin vlerën e ndërtimeve të reja dhe rikonstrukcioneve.

\*\* Në informacionin e qarkut Tiranë, mungojnë të dhënat mbi bashkinë Kamëz për tremujorin e dytë dhe tremujorin e tretë 2019.

# Metodologjia

## Përkufizime

**Leja e ndërtimit** është një autorizim për të filluar punë mbi një projekt ndërtimi. Leja është faza përfundimtare për planifikimin dhe autorizimin e ndërtimit përpara fillimit të punës.

**Ndërtesat** janë struktura të mbuluara të cilat mund të përdoren të ndara të ndërtuara për qëllime të përhershme, të përshtatshme për mbrojtjen e njerëzve, kafshëve ose objekteve. Ndërtesat klasifikohen në dy lloje të ndryshme kategorish: 1) Ndërtesa për banim (rezidente), 2) Ndërtesa të tjera (jo rezidente), ku përfshihen ndërtesat për hotele dhe të ngjashme, ndërtesa për zyra, ndërtesa industriale, ndërtesa tregtare, etj.

**Sipërfaqja** është hapësira gjithsej në metra katrorë ku do të vihet në zbatim projekti i miratuar.

**Punime Inxhinierike** janë të gjitha ndërtimet të pa klasifikuara në ndërtesa: hekurudhat, rrugë, autostrada, ura, linja ujësjellësash, linja elektrike dhe telekomunikacioni, etj.

**Klienti** është personi ose organi i cili kryen ndërtimin.

## Burimi i të dhënave

Burim administrativ, të dhënat grumbullohen nga zyrat statistikore rajonale pranë bashkive përkatëse.